



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ANDI F. RIZAJ
ADRESA NR.10, KONT URANI, NR.51
TEL: 694001353

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 1620

Nr. koleksioni: 314

Tirane më 21/04/2022

Ligjet referuese:



- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2022053310034976983

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E NOTERISE
DEGA VENDORE TIRANE

Nr. 1620 Rep.
Nr. 94 Kol.



A2022053310034976983

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

(TË SHOQËRISË "AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA" SH.A)

Sot, më datë 21 Prill 2022 (dymije e njezete e dy), ditën e Enjte, para meje **Noter ANDI F. RIZAJ**, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, KONT URANI, NR.51, u paraqit personalisht:

PALA SHITESE:

Ioannis Maleas, shtetas Grek, lindur në Lefki, Greqi, banues ne Greqi, lindur më 26/11/1949,, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. AN9147923 dhe nr. personal AN9147923.

Gëzim Norja, atësia Kasem, amësia Nadire, shtetas Shqiptar, lindur në Knete, Durrës dhe banues në SHIJAK, me adresë Sijoneve 00830136; Nd. 28; H. 1; Xhafzotaj; Xhafzotaj; 2019; Shijak, lindur më 03/03/1964, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032690010 dhe nr. personal G40303106T.

PALA BLERESE:

Shoqëria DELTA ING, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L51923514A, me seli në Tirane, me adresë Rr.Gjik Kuçali Me Numer Pasurie 5/646+114, Zona Kadastrale 8270, Volumi 69, Faqe 69, Sip.62.5 M2, përfaqësuar nga Administratorja **Blerina Legisi**, atësia Neim, amësia Fluturake, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në TIRANË, me adresë E Kosovareve; Nd. 1; H. 6; Ap. 13; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 14/01/1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036815621 dhe nr. personal I351141790.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të aksioneve të Shoqërisë "AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA" Sh.a., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Kushtet Paraprake:

Z. Ioannis Maleas është aksioner dhe zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë "AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA SHA", shoqëri tregtare e së drejtës Shqiptare, e regjistruar pranë QKB me Nipt. L11408003V, me kapital 3.500.000 lekë, të barabartë me 50 aksione, me vlerë nominale 35.000 lekë për aksion.

Fq. 1



A2022053310034976983

Z.Gëzim Norja është aksioner dhe zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë "AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA SHA", shoqëri tregtare e së drejtës Shqiptare, e regjistruar pranë QKB me Nipt. L11408003V, me kapital 3.500.000 lekë, të barabartë me 50 aksione, me vlerë nominale 35.000 lekë për aksion.

Z. Ioannis Maleas dëshiron të shesë pjesërisht aksionet e zotëruara në shoqëri, konkretisht në masën 16% të tyre, që përbëjnë 16% të kapitalit të shoqërisë, me çmim shitje 560.000 Lekë (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë).

Z.Gëzim Norja dëshiron të shesë pjesërisht aksionet e zotëruara në shoqëri, konkretisht në masën 17% të tyre, që përbëjnë 17% të kapitalit të shoqërisë, me çmim shitje 595.000 Lekë (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë).

DELTA ING shpk, deklaron se dëshiron ti blejë Z.Ioannis Maleas 16 aksione/pjesë të zotëruara në shoqëri, të barabartë me 16% të kapitalit të shoqërisë me çmim blerje 560.000 Lekë (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) dhe Z.Gëzim Norja 17 aksione/pjesë të zotëruara në shoqëri, të barabartë me 17% të kapitalit të shoqërisë me çmim blerje 595.000 Lekë (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë).

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të shoqërisë "AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA" SHA nëpërmjet Vendimit të datës 21.04.2022 ka vendosur: Miratimin e transferimit të 16 aksioneve që aksioneri Z.Ioannis Maleas zotëron në shoqëri kundrejt çmimit 560.000 Lekë, dhe 17 aksioneve që aksioneri Z.Gëzim Norja kundrejt çmimit 595.000 Lekë, të barabartë me 33 aksione me vlerë nominale 35.000 lekë/aksioni, në favor të aksionerit të ri DELTA ING shpk

Ortaku i Vetëm i shoqërisë "DELTA INGA" SHPK nëpërmjet Vendimit të datës 21.04.2022 ka vendosur: Miratimin e blerjes së 33% të aksioneve të Shoqërisë AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA" SHA nga aksionarët e kësaj shoqërie përkatësisht: 16 aksione që përbëjnë 16% të kapitalit të shoqërisë nga aksionari Z.Ioannis Maleas kundrejt çmimit prej 560.000 Lekë dhe 17 aksione që përbëjnë 17% të kapitalit të shoqërisë nga aksionari Z.Gëzim Norja kundrejt çmimit prej 595.000 Lekë.

Neni 1 Qëllimi i kontratës

Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi i pronësisë së aksioneve, që përbëjnë 33% të kapitalit të shoqërisë nga shitësit te blerësi.

Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së transferimit të pronësisë dhe pagesës përkatëse lidhur me këtë transferim.

Në përcaktim të kushteve, palët konsiderojnë të ligjshme përmbajtjen e saj dhe marrin përsipër të ekzekutojnë veprimet e tyre brenda kushteve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 2 Objekti i kontratës



A201205331003497698

Nëpërmjet kësaj kontrate, shitësit transferojnë në favor të blerësit pjesërisht aksionet e zotëruara prej tyre në shoqëri, në masën 33% të kapitalit të saj, të barabartë me 33 aksione sipas çmimit të përcaktuar në nenin 3 mëposhtë.

Blerësi do të blejë nga shitësit 33 aksione/pjesë të zotëruara prej tyre në shoqëri, të cilat përbëjnë 33 % të kapitalit të saj, përkatësisht 16 aksione/pjesë nga Z.Ioannis Maleas (16% e kapitalit) dhe 17 aksione/pjesë (17% e kapitalit) nga Z.Gëzim Norja, sipas çmimit të përcaktuar në nenin 3.



Neni 3 Çmimi dhe mënyra e pagimit

Palët kanë dakordësuar që çmimi i shitjes së 33% të aksioneve që shitësit zotërojnë në shoqëri është:

560.000 Lekë (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) kundrejt z.Ioannis Maleas për 16 aksionet/pjesët e zotëruara prej tij në Shoqëri.

595.000 Lekë (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) kundrejt Z.Gëzim Norja për 17 aksionet/pjesët e zotëruara prej tij në Shoqëri.

Po ashtu, palët deklarojnë se shumat e mësipërme prej 560.000 Lekë (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) e pesëdhjetë mijë) dhe 595.000 Lekë (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) do të shlyhet me transferte bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri me afat 20 ditë nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

Neni 4 Përgjegjësitë dhe garancitë e palëve

Shitësit nëpërmjet kësaj kontrate shitje aksionesh garanton si mëposhtë :

- Se janë të vetmit titullarë të ligjshëm të aksioneve që po transferohen me këtë kontratë shitje aksionesh;
- Se aksionet objekt shitje janë plotësisht të lira nga çdo barrë, detyrim, apo çfarëdo lloj kufizimi tjetër.
- Se transferimi i këtyre aksioneve tek blerësi është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e statutit të Shoqërisë.

Neni 5 Efektet e kontratës

Kjo kontratë ka fuqinë e ligjit për palët që nga momenti i nënshkrimit të saj përpara noterit dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim mes palëve.
Kontrata ka efekt për palët e treta në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 6 Informacioni konfidencial

Fq. 3



A202205331003497683

Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe çdo informacion të përfituar gjatë marrëdhënies se tyre në shoqëri apo marrëdhënies konkrete të krijuar me këtë kontratë.

Neni 7

Transferimi i të drejtave

Menjëherë pas nënshkrimit të palëve, kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet nga blerësi pranë QKB duke mundësuar kështu transferimin e aksioneve tek blerësi i ri.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësit zhvishen nga pronësia mbi 33 % të kapitalit të shoqërisë, i barabartë me 33 aksione (përkatësisht Z.Ioannis Maleas nga 16 aksione që përbëjnë 16% të kapitalit të shoqërisë dhe Z.Gëzim Norja nga 17 aksione që përbëjnë 17% të kapitalit të shoqërisë) dhe nga çdo e drejtë tjetër mbi to, dhe zotërues i tyre bëhet blerësi DELTA ING shpk.

Neni 8

Interpretimi i kontratës

Nëse do të jetë e nevojshme të bëhet interpretimi i kësaj kontrate, do të synohet të përcaktohet se kush ka qenë qëllimi real dhe i përbashkët i të dyja palëve, pa u mbështetur në kuptimin literal të fjalëve, dhe gjithashtu duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, përpara dhe pas përfundimit të kësaj kontrate.

Kushtet e kësaj kontrate do të interpretohen njëra pas tjetrës, duke dhënë secila kuptimin që rrjedh nga tërësia e kontratës në fjalë.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

Kontrata është hartuar në përputhje me përcaktimet e nenit 6 e vijues të statutit të Shoqërisë "AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA" SHA dhe legjislacionin tregtar në fuqi.

Blerësi dhe Shitësi angazhohen të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme që mund të krijohen midis tyre, lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negociemeve të drejtëpërdrejta.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme midis tyre, ato do të zgjidhen në baze marrëveshjeve dhe procedurave gjyqësore në fuqi sipas Legjislacionit Shqiptar.

Në çdo rast gjykata kompetente për zgjidhjen e konflikteve gjyqësore do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë është hartuar në 5 (pese) kopje, me vlerë të njëjtë ligjore nga një për secilën palë dhe ju lexua më zë të lartë e të qartë palëve nga unë noteri.

Kontrata e mësipërme, u hartua në gjuhën shqipe dhe ju lexua z. Ioannis Maleas nga perkthyesja e gjuhes greke Aleksandra Gjoni mbajtese e kartes ID me nr. F05412102R me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të pales së mësipërme.

Palët deklaruan se e dëgjuan, kuptuan dhe meqenëse e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nënshkruan personalisht dhe pa vërejtje përpara meje noterit.

Pas nënshkrimit të palëve, unë noteri e nënshkrova dhe e vërtetova kontratën sipas përcaktimeve të ligjit "Për Noterinë".



A2022053310034976983

PALA SHITËSE

Ioannis Maleas

[Handwritten signature]
Mesheri

Gëzim Norja

[Handwritten signature]
Gëzim Norja



PERKTHYES

Aleksandra Gjoni

[Handwritten signature]
Aleksandra Gjoni

PALA BLERËSE

DELTA ING shpk

perfaqesuar nga: Blerina Legisi

[Handwritten signature]
Blerina Legisi



NOTER

Andi F. Rizaj

[Handwritten signature]
Andi F. Rizaj